



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
REKTORI

Nr. 3753 prot.

Shkodër, më 31.10 .2019

Drejtuar: Znj. Besa Shahini, Ministër i Arsimit Sportit dhe Rinisë,

Për dijëni: Z. Arjan Gjonça, Kryetar i Bordit të Akreditimit

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është partner në projektin e financuar nga Bashkimi Europian me titull "MARDS - *Reformimi i studimeve doktorale në Mal të Zi dhe Shqipëri – paradigma e praktikës së mirë*" me numër 598465-EPP-1-2018-1-ME-EPPKA2-CBHE-SP dhe në këtë kuadër ka nënshkruar marrëveshjen me nr. 210 prot. datë 21.01.2019 ka nënshkruar me koordinatorin e projektit MARDS – Universitetin e Malit të Zi (me kohëzgjatje 15 nëntor 2018- 15 nëntor 2021).

Në kuadrin e këtij projekti është parashikuar që pranë fakultetit ekonomik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" të organizohet programi i ciklit të tretë studime doktorale në "Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm". Këto studime sipas projektit të sipërpërmendur janë parashikuar të fillojnë në vitin akademik 2020-2021.


Theksojmë faktin se përveç Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, partnerë tjerë në këtë projekt janë Universiteti i Vjenës, Universiteti i Zagrebit, Universiteti i Mariborit dhe Universiteti i Banska Bisticës që përbëjnë garanci për shkollën doktorale që Universiteti i Shkodrës do të organizojë.

Hapja e programit të doktoratës është shumë e rëndësishme për t'i dhënë shtysë kërkimit shkencor në universitet. Zbatimi konkret i kësaj doktorate është i lidhur me

turizmin, një sektor me rëndësi strategjike për vendin tonë dhe sidomos për Veriun e Shqipërisë. Sipas projektit parashikohet që kërkimi shkencor të orientohet nga bizneset turistike dhe aktorët e tjerë që luajnë rolin kyç në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në zonën e veriut të Shqipërisë (partnerë në projekt janë dhe Dhomat e Tregtisë të Shqipërisë dhe ajo e Malit të Zi).

Kërkojmë mbështetjen Tuaj duke vlerësuar me përparësi aplikimin, i cili në çdo rast do të jetë në mbështetje të standardeve të ciklit të tretë të studimeve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

REKTORI

Prof. dr. Adem Bekteshi
